

- M shpërndan një tregim me ilustrime (4–5 ilustrime) Detyrë: gjeni në grupe dyshe një titull atraktiv për tërë tregimin dhe nga një nëntitull për secilin ilustrim!
- M shpërndan një tekst të pandarë në pjesë, pa titull (maksimalisht 2/3 faqe). Detyrë: kërkoni një titull për tekstin, ndajeni atë në pjesë dhe formuloni mestitujt!
- M shpërndan një tregim të prerë në shirita letre (për një pjesë një shirit letre). Detyrë: gjejini renditjen e saktë, kërkoni për secilën pjesë një mes-titull; ngjitni shiritat e letres në një fletë dhe shkruani në mënyrë plotësu-ese titullin dhe mestitullin!
- M ua jep një temë N si psh.: «Referat mbi kryeqytetin tonë», «Një perso-nalitet i rëndësishëm nga kultura jonë» ose «Jeta ime mes dy kulturave». Detyrë: Nëse ju për këtë do të duhej të shkruanit një tekst ose një refe-rat: çfarë titulli dhe mestitulli do të zgjidhni për tërësinë ose për secilën pjesë?
- Detyrë (event. në vazhdim të propozimit të mësipërm): shkruani një tekst, ndajeni atë me nëntituj të përshtatshëm në së paku katër pjesë!

### 3. Ilustrimet dhe formatimi (Layout) si mjete modelimi

kl. 3–9

30 min.



- Nxitjet e mësipërme lejojnë pa probleme për t'i zgjeruar pyetjet: Si do të mund ta bëjmë tekstin edhe më të kuptueshëm e më të këndshëm për ta lexuar përmes ilustrimeve? Çfarë paraqitje/çfarë formatimi do të ndihmonte këtu?
- Përpjekjet personale dhe eksperimentet (edhe në kompjuter) do të duhej patjetër të futen në punë. Përpos ideve të theksuara, janë të përshtatshme këtu edhe p.sh. fletë pune, të cilat N në vazhdim të temave nga fusha e teksteve tematike ose në referate i bëjnë për njëri-tjetrin.

# 11

## Teknikat për përpunim dhe vetëkorrekturë

### Qëllimi

*N duhet të mësojnë që tekstet e tyre t'i përpunojnë dhe t'i organizojnë. Këtu bëhet fjalë në një rëndësi anë për aspekte përmbajtësore (kuptueshmëria, logjika e ndërtimit, atraktiviteti për lexuesit/et) dhe në anën tjetër, për aspektet formale (drejtshkrimi, sintaksa, format korrekte). Përpunimi dhe organizimi i kujdesshëm i teksteve e përkrah kompetencën në shkrim dhe formën standarde në gjuhën e parë si dhe vetëdijen për gjuhën e shkruar. Format e përpunimit të përbashkët janë me përparësi në raport me përpunimin individual, sepse e përkrahin vetëdijen për gjuhën në mënyrë interaktive dhe i shfrytëzojnë paralelisht resurset e dy ose tre nxënësve.*

### 1. Kompetenca në të shkruar: Tekstet të përpunohen bashkërisht

kl. 2–9

30 min.



Materiali:  
Fjalori i drejtshkrimit

Ky proces ndëraktiv i përpunimit të tekstit është i njohur për shumë N nga mësimi i rregullt. Është shumë i përshtatshëm edhe për mësimin në gjuhën amtare ngase e përkrah kompetencën në gjuhën standarde dhe vetëdijen ndaj së njëjtës.

- Parakusht është që N të kenë shkruar një tekst (mundësisht jo më të gjatë se një faqe). Kush e ka përfunduar tekstin e tij e mëson së pari që ta lexojë mirë. Pastaj ai/ajo kërkon një ose dy partner/e që t'i përpunojë me ta këto skica. (Varianti: M i formon ekipet redaktuese.)
- Tek ekipet redaktuese vjen njëri pas tjetrit nga një fëmijë. Ai/ajo ua lexon së pari tekstin si tërësi të tjerëve dhe i paraqet tri pyetjet vijuese (pyetjet